

Vendim nr. 79, datë 12.12.2025

(V-79/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Marsida Xhaferllari, Kryesuese, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Fiona Papajorgji, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 12.12.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (H) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: HAJRI THAÇAJ

SUBJEKT I INTERESUAR:

**DREJTORIA RAJONALE E SIGURIMEVE SHOQËRORE
TIRANË, në mungesë.**

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 1040 (86-2023-1381), datë 11.12.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-4497, datë 22.10.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe të vendimit unifikues nr. 3, datë 24.11.2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, pika 3, 7, 15, 42, 44, 55, 81, pika 1, 116, pika 1, 118, 124, 131, pika 1, shkronja “f”, 132, pika 1, 134, pika 1, shkronja “i”, 141, 142, pika 1, 145, 146, pika 2, 170, 174, 175 dhe 178 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 1, 6, 14, 17, 18 dhe 41 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit Hajri Thaça (kërkuar), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH), Tiranë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuar ka qenë me detyrë oficer pranë Komandës së Zbulimit të Forcave Tokësore me gradën “Nënkolonel” deri në nxjerrjen në rezervë me urdhrin nr. 355, datë 23.07.2003. Pas përfitimit të pagesës kalimtare në masën 23.479 lekë, kërkuar i është drejtuar DRSSH-së, Tiranë për përfitimin e pensionit të parakohshëm, e cila ka caktuar pensionin me vendimin nr. 4394, datë 01.08.2005, në masën 15.693 lekë në muaj, për periudhën e shërbimit 34 vjet. Ndërkohë, në datën 04.05.2016 kërkuar ka dalë në pension pleqërie.

2. Duke mos qenë dakord me masën e pensionit të parakohshëm, në datën 17.11.2006 kërkuar i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, me objekt detyrimin e të paditurit të paguajë masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi sipas nenit 11 të ligjit nr. 8087, datë 13.03.1996 (ligj nr. 8087/1996). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4887, datë 05.06.2009, ka vendosur: pranimin e kërkesëpadisë; detyrimin e palës së paditur, DRSSH-së, Tiranë, të rillogarisë masën e pensionit të parakohshëm të kërkuarit në masën 50% të pagës referuese mbi të cilën është derdhur kontributi dhe për çdo vit tjetër të vjetërsisë të shërbimit mbi përcaktimin e mësipërm masa e pensionit shtohet me 2% të pagës referuese; detyrimin e palës së paditur t'i paguajë diferencën e masës së pensionit që nga data e fillimit të pensionit 01.08.2005 deri në 30.04.2009. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 438, datë 12.03.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 4887, datë 05.06.2009 të gjykatës së shkallës së parë. Me vendimin nr. 00-2012-2012, datë 11.10.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga DRSSH-ja, Tiranë (procesi i parë gjyqësor). Në zbatim të këtyre vendimeve kërkuar i është përlloritur masa e pensionit në shumën 52.584 lekë në muaj.

3. DRSSH-ja, Tiranë, në zbatim të ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në

Republikën e Shqipërisë” (ligj nr. 10142/2009), ka përlllogaritur pensionin e parakohshëm të kërkuarit me të drejtë pagese nga data 01.07.2009 në masën 21.439 lekë në muaj.

4. Me vendimin nr. 33, datë 24.06.2010 (vendim nr. 33/2010) Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka vendosur shfuqizimin si antikushtetuese të pikës 2 të nenit 14, si dhe të nenit 27 të ligjit nr. 10142/2009. Në vijim të këtij vendimi, kërkuari i është drejtuar sërish gjykatës, duke kërkuar detyrimin e palës së paditur, DRSSH-së, Tiranë, për të vazhduar pagesën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar si rezultat i moszbatimit të vendimit të Gjykatës nr. 33/2010 për periudhën 01.05.2009-04.03.2013, duke e llogaritur pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën 50% të pagës referuese mbi të cilën është derdhur kontributi dhe duke i shtuar kësaj mase 2% të pagës referuese për çdo vit shërbimi mbi periudhën 15 vjet si një të drejtë të fituar; indeksimin e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe shpërblimin e dëmit.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10410, datë 21.10.2013, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë; detyrimin e palës së paditur, DRSSH-së, Tiranë, për t’i paguar kërkuarit pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën 50% të pagës referuese për 15 vjet shërbimi, duke i shtuar kësaj mase 2% të pagës referuese për çdo vit shërbimi mbi periudhën 15 vjet, duke u paguar diferenca midis masës së pensionit që do të dalë dhe masës së pensionit që kërkuari ka përfituar për çdo muaj, duke filluar nga data 01.05.2009 deri në datën 01.07.2009; detyrimin e palës së paditur për t’i paguar pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi për periudhën nga 01.05.2009-01.07.2009 bashkë me rritjet përkatëse; rrëzimin e kërkesëpadisë për sa i përket shpërblimit të dëmit. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuari dhe pala e paditur.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1591, datë 22.04.2014, ka vendosur moskompetencën e shqyrtimit të çështjes dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Apelit. Kjo e fundit, me vendimin nr. 4331, datë 27.11.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 10410, datë 21.10.2013. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs pala e paditur dhe kërkuari.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2017-1378 (724), datë 23.06.2017, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 4331, datë 27.11.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues, duke arsyetuar se gjykatat e faktit kanë zbatuar gabim ligjin material dhe në rigjykim duhet të analizohen faktet për të zgjidhur çështjen duke zbatuar ligjin sipas orientimeve të vendimit unifikues nr. 3, datë 24.11.2016 të Kolegjeve të Bashkuara (vendimi unifikues nr. 3/2016). Kundër këtij vendimi

të Kolegjit Administrativ kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatë. Me vendimin nr. 21, datë 19.12.2019, Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se kërkuesi nuk kishte shteruar mjetet juridike efektive në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, si dhe kërkesa ishte paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor.

8. Në rigjykim, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1040 (86-2023-1381), datë 11.12.2023, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 10410, datë 21.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e padisë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi.

9. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-4497, datë 22.10.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se në të nuk ngriheshin shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligj nr. 49/2012*), (*procesi i dytë gjyqësor*).

10. Në datën 19.03.2025 (*sipas shënimit të shërbimit postar*) kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili është regjistruar në datën 20.03.2025. Në datën 04.06.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 18.06.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Me vendimin e datës 11.12.2025 Mbledhja e Gjyqtarëve ka pranuar kërkesën e një gjyqtari për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar si vijon:

A. *Vendimi unifikues nr. 3/2016 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ka cenuar:*

11.1. *Të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:*

11.1.1. *Parimit të sigurisë juridike në drejtim të të drejtave të fituara dhe res judicata*, pasi kërkuesi ka përfituar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për periudhën 01.08.2005-01.07.2009 me vendim gjyqësor të formës së prerë. E drejta e këtij pensioni është fituar më parë edhe me ligjin nr. 8087/1996, të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, nenin 49 të ligjit nr. 9210/2004 dhe vendimin nr. 33/2013 të Gjykatës. Pra, atij i lind e drejta e vazhdimësisë të së drejtës së fituar më parë deri në plotësimin e moshës për

pension të plotë pleqërie. Gjykata e Lartë nuk ka marrë në konsideratë vendimin nr. 33/2010 të Gjykatës, i cili ka hyrë në fuqi përpara vendimit nr. 2/2013 të kësaj të fundit dhe vendimit unifikues. Vendimi nr. 2/2013 i Gjykatës nuk e ka shfuqizuar vendimin e saj të mëparshëm, prandaj e drejta e pensionit të kërkuarit është fituar me vendimin nr. 33/2010.

11.1.2. *Parimit të gjykimit të drejtë*, pasi e drejta e pensionit të parakohshëm ka lindur në datën 01.08.2005, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9210/2004 dhe neni 11 i ligjit nr. 8087/1996 duhet të zbatohet sipas nenit 49 të ligjit 9210/2004, sipas të cilit shprehja “jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi” është shfuqizuar. Kolegjet e Bashkuara në vendimin unifikues nuk e kanë pranuar zbatimin e këtij neni, me argumentin se nuk ishin miratuar aktet nënligjore, ndonëse kanë pasur detyrimin e zbatimit të tij. Në këtë mënyrë ato kanë marrë kompetencat e organit ligjvënës, kanë shkelur nenin 141 të Kushtetutës dhe kanë ndryshuar ligjin pas një periudhe 11-vjeçare, ndonëse vendimet e gjykatave për pensionin e parakohshëm kishin marrë formë të prerë dhe ishin ekzekutuar. Gjykata në vendimin e saj nr. 2/2013 është mbështetur në prova fiktive të paraqitura nga subjektet e interesuara në atë gjykim, pa shifra dhe pa llogaritur borxhin publik. Për rrjedhojë, Gjykata duhet të konstatojë shkelje edhe të vendimit të saj nr. 2/2013.

11.2. *Të drejtën për mbrojtjen shoqërore të punës*, të garantuar nga neni 49, paragrafi 2, i Kushtetutës, pasi vendimi unifikues nr. 3/2016 ul në mënyrë të ndjeshme deri në 50% përfitimin financiar të pensionit të parakohshëm, duke e përgjysmuar dhe duke përkeqësuar situatën financiare dhe ekonomike në nivelin jetik, pra nën pagën minimale. Ushtarakët nuk kanë profesion tjetër dhe ata nuk mund të angazhohen në punë të tjera, pasi kjo kategori është e moshuar. Gjithashtu, ushtarakët nuk kanë të ardhura të tjera shtesë dhe familja jeton me pensionin e tyre. Ushtarakët nuk përfitojnë as të drejta suplementare financiare.

11.3. *Të drejtën për pension*, të garantuar nga neni 52 i Kushtetutës, pasi kufizimi i pensionit të parakohshëm të ushtarakëve nuk plotëson kriteret e kufizimit të nenit 17 të Kushtetutës, pasi nuk është bërë për një interes publik. Po kështu, kufizimi nuk është bërë me ligj, por me vendime gjyqësore, si vendimi i Gjykatës nr. 33/2010 dhe vendimi unifikues nr. 3/2016. Ligji nr. 10142/2009 nuk ka

parashikuar shpenzimet financiare për zbatimin e tij. Kushtetuta dhe kuadri ligjor nuk parashikojnë kufizimin e pensionit të parakohshëm. Shkaqet e kufizimit të kësaj të drejte nga vendimi unifikues janë alogjike, pasi përballimi i pasojave në buxhetin e shtetit nuk mund të bëhet vetëm nëpërmjet kufizimit të drejtave të ushtarakëve.

- 11.4. *Parimin e proporcionalitetit*, të garantuar nga neni 17 i Kushtetutës, pasi pensioni i parakohshëm i llogaritur sipas vendimeve të formës së prerë ka qenë në masën 52.584 lekë, ndërsa pas prishjes së tyre nga Gjykata e Lartë ai është ulur në masën mbi 50%. Nga dalja e vendimit të Gjykatës nr. 2/2013 deri në vendimin unifikues të vitit 2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ka kaluar një periudhë 3-vjeçare dhe ky vendim i fundit nuk ka marrë parasysh se interesi publik ka ndryshuar si rezultat i inflacionit, borxhit publik, etj.
- 11.5. *Parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi kufizimi i pensionit të parakohshëm është bërë vetëm për ushtarakët, për shkak të përkatësisë shoqërore të tyre dhe gjendjes ekonomike. Ndikimi në buxhetin e shtetit, reduktimi i borxhit publik etj. nuk mund të përballohen vetëm nga ushtarakët. Shumë kategori të tjera funksionarësh publikë nuk janë prekur nga ulja e pensionit të parakohshëm. Ky parim është cenuar nga vendimi unifikues nr. 3/2016, i cili ka prekur vetëm pensionet e ushtarakëve.
- 11.6. *Parimin e moszbatimit të fuqisë prapavepruese*, pasi pensioni i parakohshëm i kërkuesit është caktuar në datën 01.08.2005, përpara hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës nr. 3/2013 dhe vendimit unifikues dhe ligji i zbatueshëm ishte ligji në fuqi në kohën e lindjes të së drejtës, konkretisht ai nr. 8087/1996, i ndryshuar. Edhe Gjykata nuk mund të ndryshojë të drejtën e pensionit me një vendim tjetër të saj. Kolegjet e Bashkuara i kanë dhënë fuqi prapavepruese nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009, ndonëse ai parashikon se rilogaritja bëhet vetëm për ata persona për të cilët pensioni i parakohshëm nuk është caktuar, në ndryshim nga situata e kërkuesit, duke marrë kompetencat e pushtetit ligjvënës.
- 11.7. *Të drejtën për informim*, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka vënë në dispozicion kërkuesit kopje të dosjes gjyqësore të vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Palë në atë gjykim ishte shoqata e ushtarakëve, pjesë e së cilës është edhe kërkuesi, për rrjedhje ai ka të drejtë të njihet me dosjen gjyqësore që i përket vendimit unifikues. Ky vendim i shtrin

efektet financiare jo vetëm te palët ndërgjyqëse, por tek të gjithë personat që preken prej tij.

11.8. *Parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve*, pasi Gjykata e Lartë ka ndryshuar përmbajtjen e nenit 11, shkronja “b”, të ligjit nr. 8087/1996 dhe ka shfuqizuar nenin 49 të ligjit nr. 9210/2004, duke shtuar fjalët “por masa e përgjithshme e pensionit të parakohshëm nuk mund të kalojë masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi”. Kjo gjykatë nuk ka respektuar Kushtetutën, por ka vepruar në kundërshtim me nenet 7 dhe 141 të saj. Neni 48 i ligjit nr. 9210/2004 nuk delegonte Këshillin e Ministrave të nxirrte akte nënligjore për zbatimin e nenit 49 të tij. Gjykata e Lartë ka marrë kompetencat e ligjvënësit. Ligji nr. 8087/1996 dhe neni 49 i ligjit nr. 9210/2004 prevalojnë mbi vendimin unifikues, pra edhe njësimi i praktikës gjyqësore cenon parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

B. *Vendimi nr. 00-2024-4497, datë 22.10.2024 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ka cenuar:*

11.9. *Parimin e gjykimit të drejtë*, pasi rekursi i kërkuarit është paraqitur në përputhje me nenin 475 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), në të cilin janë pasqyruar shkaqet e parashikuara në nenin 58, shkronja “a”, të ligjit nr. 49/2012. Vlerësimet e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë janë jologjike, ndonëse kërkuari ka paraqitur shkaqe që lidhen me interpretimin e kuadrit ligjor për pensionin e parakohshëm të ushtarakëve.

11.10. *Të drejtën e aksesit*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka keqinterpretuar rekursin, duke mos e gjykuar çështjen e tij.

11.11. *Standardin e arsytimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë duhet të analizonte shkaqet e rekursit referuar nenit 58, shkronja “a”, të ligjit nr. 49/2012. Ajo gjykatë ka bërë një vlerësim jologjik dhe nuk është bazuar në nenin 480/a të KPC-së dhe nenin 58 të ligjit nr. 49/2012.

11.12. *Parimin e subsidiaritetit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka kontrolluar respektimin e standardeve kushtetuese dhe nuk ka analizuar pretendimet e paraqitura në rekurs, duke anashkaluar shkeljet kushtetuese.

11.13. *Parimin e disponibilitetit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka konstatuar se gjykata e apelit e ka gjykuar çështjen në kundërshtim me kufijtë e shqyrtimit gjyqësor.

C. *Vendimi nr. 1040 (86-2023-1381), datë 11.12.2023 i Gjykatës Administrative të Apelit ka cenuar:*

11.14. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor, në drejtim të:*

11.14.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka njoftuar kërkuesin për datën dhe orën e zhvillimit të seancës gjyqësore në përputhje me nenin 460, pika 5, të KPC-së. Në këtë mënyrë kërkuesit nuk i është dhënë mundësia për të paraqitur pretendimet e tij në lidhje me vendimin unifikues nr. 3/2016. Mosnjoftimi i kërkuesit ka sjellë si pasojë pamundësinë e tij për të kërkuar përjashtimin e relatorit të çështjes, E.R., ndaj të cilit ai kishte paraqitur kallëzim penal.

11.14.2. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi gjykata e apelit nuk është shprehur për pretendimet e kërkuesit të paraqitura në kërkesat e datave 19.04.2019, 28.05.2019 dhe parashtrimet e datës 16.07.2019, kërkesat për themelin e vendimit, pretendimet lidhur me shkeljet kushtetuese, përparësinë e zbatimit të ligjit nr. 8087/1996, si dhe saktësinë e fakteve të pranuar nga gjykimi i mëparshëm. Kjo gjykatë nuk ka pasqyruar të dhënat e vendimit të kërkuesit, çka ngre dyshimin se bëhet fjalë për vendimin e një pale tjetër. Vendimit i mungon arsyetimi për zbatimin e ligjit, por thjesht bëhet referim në vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë dhe vendimin unifikues. Në këtë mënyrë kjo gjykatë nuk ka kryer hetim të plotë.

11.14.3. *Parimit të disponibilitetit*, pasi gjykata e apelit nuk i është referuar situatës ligjore që ekzistonte në datën 01.08.2005, koha e përfitimit të pensionit të parakohshëm, pra pas hyrjes në fuqi të nenit 49 të ligjit nr. 9210/2004.

11.14.4. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi relatori i çështjes është në konflikt interesi me kërkuesin, për shkak se ai ka paraqitur kallëzim penal për këtë gjyqtar.

11.14.5. *Parimit të gjykimit të drejtë*, pasi vendimi i gjykatës së apelit nuk është bazuar në të drejtën e fituar me ligjet e mëparshme dhe llogaritja e pensionit të parakohshëm nuk është bërë sipas të drejtës së fituar më parë.

12. *Subjekti i interesuar, DRSSH-ja, Tiranë*, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, megjithëse është njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësit

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Gjykata vëren se kërkuësi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, për kundërshtimin e vendimeve nr. 1040 (86-2023-1381), datë 11.12.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe nr. 00-2024-4497, datë 22.10.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

15. Për sa i takon vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjithashtu objekt i ankimit kushtetues individual, Gjykata vëren se sipas jurisprudencës kushtetuese, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij, si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 59, datë 16.10.2025; nr. 77, datë 05.11.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, kërkuësi nuk ka qenë palë në procesin ku është dhënë vendimi unifikues i kundërshtuar, ndaj, në aspektin procedural, ai nuk legjitimohet *ratione personae* për kundërshtimin e tij. Megjithatë, në aspektin substancial, Gjykata çmon të analizojë përmbajtjen e vendimit unifikues për aq sa referuar atij gjykatat e zakonshme kanë interpretuar dhe zbatuar ligjin në çështjen konkrete.

16. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave

kushtetuese, që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Kriteri për shterimin e mjeteve nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha shkallëve të zakonshme të gjykimit, por edhe që të gjitha pretendimet që ngrenë në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 50, datë 20.06.2024; nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 31, datë 03.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata vëren se kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pasi relatori i çështjes në gjykatën e apelit ka qenë në konflikt interesi me kërkuenin, për shkak se ka paraqitur kallëzim penal për këtë gjyqtar. Lidhur me këtë pretendim, kërkuesi ka pretenduar se Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka njoftuar për datën dhe orën e zhvillimit të seancës gjyqësore, në mënyrë që atij t'i jepej mundësia për të kërkuar përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjes.

18. Bazuar në nenin 49 të ligjit nr. 49/2012, Gjykata vëren se shqyrtimi i ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit si rregull bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit dhe sekretaria e gjykatës njofton palët rregullisht sipas rregullave procedurale në gjykimin civil në Gjykatën e Lartë, për përbërjen e trupit gjykues, datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes, të paktën 15 ditë përpara. Ndërkohë, rregullat procedurale në gjykimin civil në Gjykatën e Lartë, pikërisht neni 482, paragrafi i tretë, i KPC-së, parashikojnë se njoftimi i palëve nga sekretaria gjyqësore bëhet përmes shpalljes së listave të shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit.

19. Në rastin konkret, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues, seanca e planifikuar në datën 08.10.2023 në Gjykatën Administrative të Apelit nuk është zhvilluar për shkak të mosformimit të trupit gjykues, si rrjedhojë e kërkesës për dorëheqje të gjyqtarës E.Ç., e cila është pranuar nga zëvendëskryetari i asaj gjykate. Më tej është proceduar me plotësimin e përbërjes së trupit gjykues nëpërmjet shortit elektronik. Seanca e planifikuar është shtyrë me qëllim njoftimin e palëve ndërgjyqëse me shpallje publike në ambientet e gjykatës dhe në faqen zyrtare të saj. Njoftimi për datën dhe orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues rezulton të jetë shpallur në datën 17.11.2023. Në kuptim të këtyre rrethanave, Gjykata çmon se gjykata e apelit ka vepruar në përputhje me parashikimet ligjore për sa i përket njoftimit të palëve. Në këto kushte, ndonëse kërkuesi rezulton të jetë njoftuar rregullisht, ai nuk ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit E.R. nga gjykimi i çështjes së tij. Për rrjedhojë, për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, ai nuk ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "F", të Kushtetutës. Ndërsa për sa u përket

pretendimeve të tjera, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

20. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin konkret, vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 22.10.2024, i cili është publikuar në faqen zyrtare të kësaj gjykate në datën 20.11.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 15.01.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

21. Për sa u përket pretendimeve për cenimin e parimit të disponibilitetit dhe subsidiaritetit nga Gjykata e Lartë, si dhe të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve nga vendimi unifikues, Gjykata vëren se kërkuesi i ka paraqitur për herë të parë në parashtrimet para seancës të datës 22.07.2025, pra si të tilla ato përbëjnë shtesë të shkaqeve të ankimit kushtetues individual. Referuar nenit 1, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës dhe nenit 185 të KPC-së, shkaqet e ankimit kushtetues mund të ndryshohen (shtohen ose pakësohen) deri në momentin që vendoset kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare (*shih vendimin nr. 63, datë 20.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata çmon se këto pretendime të reja nuk mund të merren në shqyrtim, pasi ato janë paraqitur nga kërkuesi pasi ishte vendosur kalimi i çështjes në seancë plenare.

22. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi për procesin gjyqësor për masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, si në gjykatën e apelit, ashtu edhe në Gjykatën e Lartë, në drejtim të parimit të gjykimit të drejtë, së drejtës së aksesit, standardit të arsyetimit të vendimit dhe parimit të disponibilitetit.

23. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës së aksesit, kërkuesi ka pretenduar se Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka njoftuar për datën dhe orën e zhvillimit të seancës gjyqësore. Gjykata, në kushtet kur konstatoi se njoftimi i kërkuesit është bërë në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse (*shih paragrafin 19 të vendimit*), çmon se pretendimi i tij është haptazi i pabazuar. Ndërsa për sa i përket pretendimit për cenimin e kësaj të drejte nga Gjykata e Lartë, kërkuesi ka argumentuar se kjo e fundit ka keqinterpretuar rekursin, duke mos e gjykuar çështjen e tij, pretendim i cili bazuar në thelbin e tij do të analizohet në kuadër të parimit të gjykimit të drejtë.

24. Për sa u takon pretendimeve për cenimin e parimit të gjykimit të drejtë, standardit të arsyetimit të vendimit dhe parimit të disponibilitetit, Gjykata vëren se, për sa kohë, në thelb,

kërkuesi ka paraqitur të njëjtat argumente që lidhen me mënyrën e interpretimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme, ato do të trajtohen në vijim në drejtim të së drejtës për gjykim të drejtë, të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, të lidhur me parimin e sigurisë juridike.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë të lidhur me parimin e sigurisë juridike

25. Kërkuesi ka pretenduar se gjykata e apelit nuk është shprehur në lidhje me objektin e kërkesave dhe parashtrimeve të tij, për pretendimet lidhur me shkeljet kushtetuese, përparësinë e zbatimit të ligjit nr. 8087/1996 dhe saktësinë e fakteve të pranuar nga gjykimi i mëparshëm. Sipas tij, e drejta e pensionit të parakohshëm është një e drejtë e fituar më parë me ligjin nr. 8087/1996 dhe vendimin nr. 33/2013 të Gjykatës, si dhe me vendime gjyqësore të formës së prerë. E drejta e pensionit të parakohshëm ka lindur në datën 01.08.2005, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9210/2004 dhe neni 11 i ligjit nr. 8087/1996 duhet të zbatohet sipas nenit 49 të ligjit 9210/2004, sipas të cilit shprehja “jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi” ishte shfuqizuar. Sipas kërkuesit, pensioni i parakohshëm i tij është caktuar në datën 01.08.2005, përpara hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës nr. 3/2013 dhe vendimit unifikues dhe ligji i zbatueshëm ishte ligji në fuqi në kohën e lindjes të së drejtës, konkretisht ai nr. 8087/1996, i ndryshuar. Po kështu, sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë nuk ka analizuar shkaqet e rekursit referuar nenit 58 të ligjit nr. 49/2012, ndonëse ai ka paraqitur shkaqe që lidhen me interpretimin e kuadrit ligjor për pensionin e parakohshëm të ushtarakëve.

26. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës, ndër të tjera, parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. E thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 25, datë 23.04.2025; nr. 24, datë 23.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Për sa i përket parimit të sigurisë juridike, si një nga elementet e parimit të shtetit të së drejtës, Gjykata ka theksuar se, ai përfshin, mes të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve të shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Nëse masat e marra shpiten në përkeqësimin në mënyrë të paarsyeshme të gjendjes ligjore të personave të tjerë, mohojnë të drejtat e fituara ose injorojnë interesat legjitimë të tyre, atëherë do të rrezikohet arritja e qëllimit madhor të ndërtimit të shtetit të së drejtës. Në këtë kuptim, parimi i sigurisë juridike nuk shfaqet asnjëherë si i tillë në vetvete, por shoqërohet me mbrojtjen e të drejtave të fituara, vazhdimësinë ligjore, qartësinë dhe përcaktueshmërinë në normimin e marrëdhënieve juridike dhe respektimin e pritshmërive legjitime (*shih vendimet nr. 25, datë 23.04.2025; nr. 10, datë 29.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Po në drejtim të parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se ai përfshin edhe ndalimin e fuqisë prapavepruese të normave juridike, i cili nënkupton se është e pamundur të gjykohej, sipas normave ligjore në fuqi, sjellje njerëzore, fakte ligjore ose marrëdhënie ligjore që kanë ndodhur përpara se këto norma të hynin në fuqi. Si rregull, ligjet i shtrijnë efektet e tyre në kohën e ardhme dhe fuqia prapavepruese zbatohet në raste përjashtimore, sepse, në të kundërt, mund të krijohen situata me pasoja të paparashikuara (*shih vendimet nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 78, datë 06.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Fuqia prapavepruese zbatohet si përjashtim në ligjet penale favorizuese, në ligjet që ndërhyjnë për të rregulluar me ligj situata të paligjshme të krijuara më parë, në ligjet që interpretojnë anët e errëta ose të paqarta të një ligji të mëparshëm ose në ndonjë rast tjetër ku paraqitet domosdoshmëria për të shmangur pasoja të rënda, negative ose të pandreqshme (*shih vendimet nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 9, datë 26.02.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Nocioni i fuqisë prapavepruese është i pranishëm në rastet kur një normë ligjore aplikohet për gjëra tashmë të vendosura në të kaluarën. Në aspektin kushtetues, ligji me fuqi prapavepruese është i kundërshtueshëm në qoftë se cenon të drejtat e fituara me ligjet ekzistuese ose krijon një detyrim të ri për sa u përket transaksioneve të shkuara (*shih vendimet nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 1, datë 31.01.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjykata gjithashtu çmon të ritheksojë edhe se pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi jepet në konsideratë të natyrës së punës të ushtarakëve, të cilët pas ndërprerjes së karrierës, me ose pa dëshirën e tyre, e kanë të vështirë të gjejnë një vend pune të një niveli të krahasueshëm me funksionet që ushtronin. Prandaj ligjvënësi parashikoi krijimin e një sistemi

përfitimesh suplementare që të garantohej ruajtja e një niveli të krahasueshëm jetese dhe ekonomik për ushtarakët e Forcave të Armatosura, të cilëve u ndërpriteshin marrëdhëniet e punës. Në këtë këndvështrim, pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi mbrohet nga parimi i sigurisë juridike (shih vendimet nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 25, datë 23.04.2025; nr. 33, datë 24.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

30. Në praktikën e saj Gjykata ka marrë tashmë në analizë pretendimet për masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për ish-ushtarakët në disa raste (shih vendimet nr. 74, datë 20.11.2025; nr. 59, datë 16.10.2025; nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 25, datë 23.04.2025; nr. 24, datë 23.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese), prandaj për legjislacionin që ka rregulluar ndër vite të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për ushtarakët e Forcave të Armatosura, kontrollin e tyre kushtetues dhe për sa u përket përfundimeve njësuere të vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për zbatimin në kohë dhe efektin prapaveprues të legjislacionit për pensionin e parakohshëm, si dhe skemën e zbatueshme për llogaritjen e masës së këtij pensioni, çmon të mos ndalet në evidentimin e tij në hollësi edhe në këtë vendim.

31. Në referim të sa më sipër, nisur nga thelbi i parashtrimeve të kërkuarit, si dhe bazuar në standardet kushtetuese të sipërcituara, Gjykata në vijim do të analizojë nëse interpretimi që Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë bërë ligjit material të zbatueshëm në mosmarrëveshjen objekt gjykimi i ka cenuar kërkuarit të drejtën për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të përfituar për shkak të parashikimeve ligjore, pra nëse në interpretimin që ato gjykata i kanë bërë ligjit të zbatueshëm në rastin e kërkuarit ka ose jo elemente të arbitraritetit.

32. Po kështu, Gjykata sjell në vëmendje se pretendimet e kërkuarit për sa i përket së drejtës për pension të parakohshëm lidhen si me periudhën para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10149/2009, ashtu dhe me periudhën pas hyrjes në fuqi të tij (01.07.2009). Në këtë drejtim, ndonëse në rastin e kërkuarit e drejta e pensionit të parakohshëm për periudhën deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10149/2009 i korrespondon një periudhe të shkurtër kohore (01.05.2009-01.07.2009) e për pasojë një vlerë relativisht të vogël monetare, duke mbajtur në konsideratë se pensioni i parakohshëm për ushtarakët e Forcave të Armatosura garanton ruajtjen e një niveli të krahasueshëm jetese dhe ekonomike për ta, Gjykata çmon ta analizojë pretendimin e tij edhe për këtë periudhë.

33. Konkretisht, Gjykata vëren se në datën 23.07.2003 kërkuari është nxjerrë në rezervë, pasi ka shërbyer si oficer aktiv me gradën “Nënkolonel”. Fillimisht, ai është trajtuar me pagesë kalimtare bazuar në ligjin nr. 8087/1996, të ndryshuar. E drejta e pensionit të parakohshëm i ka lindur në datën 01.08.2005, masa e të cilit është kundërshtuar nga kërkuari në gjykatë. Për procesin

e parë gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 2009 ka vendosur pranimin e kërkesëpadiisë së kërkuesit dhe se atij duhet t'i kthehen diferencat e masës së pensionit nga data 01.08.2005, kur i ka lindur e drejta, deri në datën 30.04.2009. Ky vendim është lënë në fuqi nga gjykata e apelit, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të palës së paditur.

34. Në vijim të vendimit nr. 33/2010 të Gjykatës, kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, me objekt detyrimin e palës së paditur, DRSSH-së, Tiranë, për të vazhduar pagesën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar si rezultat i moszbatimit të vendimit të Gjykatës nr. 33/2010 për periudhën 01.05.2009-04.03.2013, duke e llogaritur pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën 50% të pagës referuese mbi të cilën është derdhur kontributi dhe duke i shtuar kësaj mase 2% të pagës referuese për çdo vit shërbimi mbi periudhën 15 vjet si një e drejtë e fituar; indeksimin e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe shpërblimin e dëmit.

35. Për procesin e dytë gjyqësor, objekt kundërshtimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10410, datë 21.10.2013, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadiisë dhe detyrimin e palës së paditur për të paguar pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën 50% të pagës referuese për 15 vjet shërbimi, duke i shtuar kësaj mase 2% të pagës referuese për çdo vit shërbimi mbi periudhën 15 vjet, duke u paguar diferenca midis masës së pensionit që do të dalë dhe masës së pensionit që kërkuesi ka përfituar për çdo muaj duke filluar nga data 01.05.2009 deri në datën 01.07.2009; detyrimin për t'i paguar pensionin e parakohshëm për periudhën nga 01.05.2009-01.07.2009 bashkë me rritjet përkatëse dhe rrëzimin e kërkesëpadiisë për sa i përket shpërblimit të dëmit. Kjo gjykatë ka arsyetuar se ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është ligji nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999. Sipas saj, DRSSH-ja ka gabuar në përllogaritje, pasi kufizimi “jo më shumë se pensioni maksimal në shkallë vendi” ka qenë i shfuqizuar kur kërkuesi ka dalë në rezervë dhe prandaj atij duhet t'i paguhet diferenca e masës së pensionit nga data 01.05.2009 deri në datën 01.07.2009. Kjo gjykatë gjithashtu ka pranuar edhe kërkimin për indeksimin e pensionit të parakohshëm.

36. Gjykata Administrative e Apelit, si gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes, me vendimin nr. 4331, datë 27.11.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas saj, në momentin kur kërkuesi ka dalë në rezervë, shprehja “por jo më shumë se pensioni maksimal në shkallë vendi” në nenin 49 të ligjit 9210/2004 është shfuqizuar dhe pala e paditur duhet të bazohet në nenin 35 të ligjit 9210/2004, i cili parashikonte se oficerët gëzojnë të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën 50 % të pagës mujore deri në plotësimin e kushteve për përfitimin e pensionit të pleqërisë dhe për çdo vit tjetër shërbimi

mbi kufirin e mësipërm ushtarakut i jepet një shtesë pensioni në masën 2 për qind të pagës mujore. Për rrjedhojë, sipas gjykatës, pala e paditur duhet të bazohet në nenet 13 dhe 14 të ligjit nr. 9418/2005, të ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006 dhe t'i paguajë kërkuesit diferencën e masës së pensionit nga data 01.05.2009 deri në datën 01.07.2009.

37. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vitin 2017 ka vendosur prishjen e vendimit nr. 4331, datë 27.11.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Ky kolegji ka arsyetuar se gjykatat e faktit kanë zbatuar gabim ligjin material dhe në rigjykim duhet të analizohen faktet për të zgjidhur çështjen duke zbatuar ligjin sipas orientimeve të vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara.

38. Në rigjykim, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1040 (86-2023-1381), datë 11.12.2023, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 10410, datë 21.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e padisë. Ajo gjykatë ka arsyetuar se gjykata e shkallës së parë ka interpretuar në mënyrë të gabuar nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996, të ndryshuar me ligjin nr. 8251/1999, duke e vendosur kufizimin e masës maksimale të pensionit në shkallë vendi të shtesa për vjetërsi dhe jo në masën totale të pensionit. Në këtë konkluzion gjykata e apelit ka arritur duke u mbështetur në arsyetimin e vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara.

39. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-4497, datë 22.10.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se në të nuk ngriheshin shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2021. Sipas këtij kolegji, është detyrë e palës rekursuese të parashtojë qartësisht dhe në mënyrë të plotë në rekurs shkaqet ligjore, duke argumentuar se përse është zbatuar në mënyrë të gabuar nga gjykata ligji material ose procedural dhe përse shkalla e shkeljes është e një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, si dhe cilat janë ato shkelje të rënda procedurale që ndikojnë dukshëm në dhënien e vendimit. Po sipas kolegjit, nëse shkaqet ligjore nuk arrihen të parashtrihen dhe të argumentohen sipas kërkesave që ka neni 58 i ligjit nr. 49/2012, atëherë Gjykata e Lartë është e detyruar të vendos mospranimin e rekursit.

40. Duke marrë në konsideratë rrethanat e rastit konkret dhe bazuar në standardet kushtetuese të mësipërme, Gjykata vëren se kërkuesit i ka lindur e drejta për pension të parakohshëm në datën 01.08.2005, moment në të cilin zbatohet ligji 9210/2004. Në pikën 3 të nenit 35 të këtij ligji ishte përcaktuar se kriteret dhe kushtet e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi përcaktoheshin në ligjin nr. 8087/1996, të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999. Në nenin 11 të ligjit të fundit parashikohej se masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi ishte 50% e pagës referuese mbi të cilën ishte derdhur kontributi dhe për çdo vit tjetër të vjetërsisë

së shërbimit mbi përcaktimin e mësipërm, masa e pensionit shtohet me 2% të pagës referuese, por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi. Ndërkohë, për shkak të shfuqizimit me ligjin nr. 9210/2004 të tavanit të masës së pensionit maksimal të pleqërisë, por edhe të vendimmarrjeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm gjatë procesit të parë gjyqësor, kërkuesi kishte prishmëri të ligjshme se ai do të përfitonte nga ky shfuqizim, pra se ndaj atij nuk do të zbatohet ky kufizim në masën e pensionit të parakohshëm të paktën deri në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10142/2009.

41. Nisur nga sa më sipër, për sa i përket periudhës së përfitimit nga kërkuesi të pensionit të parakohshëm deri në datën 01.07.2009, Gjykata, në linjë edhe me vendimmarrjen e mëparshme të saj, vëren se pavarësisht shfuqizimit të tavanit maksimal të pensionit të parakohshëm me nenin 49 të ligjit nr. 9210/2004, Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka përlllogaritur masën e pensionit sipas parashikimit ligjor në fuqi për atë periudhë, por ka përcaktuar se masa e përgjithshme e pensionit të parakohshëm nuk mund të kalojë masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi, duke vlerësuar se ligji nr. 9210/2004 nuk mund të zbatohet për mungesë të daljes së akteve nënligjore për zbatimin e tij.

42. Duke arsyetuar si më lart, Gjykata Administrative e Apelit nuk duket se ka mbajtur parasysh rregullimet e nenit 37, pika 1, të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit gjykata e shqyrtton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet në bazë të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ, duke mos marrë në konsideratë përlllogaritjen e masës së pensionit, kushtet dhe kriteret, sipas parashikimeve ligjore në fuqi për atë periudhë. Prandaj, në vlerësimin e Gjykatës vendimi i gjykatës së apelit nuk duket se ka përmbushur konceptin e një gjykimi të drejtë në kuptim të parashikimit të nenit 42 të Kushtetutës.

43. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se përmbajtja e ligjit nr. 9210/2004, si dhe mënyra e interpretimit të tij nga gjykata e apelit nuk rezultojnë të jenë analizuar nga Gjykata e Lartë. Gjithashtu, ajo nuk shprehet pse në rastin në shqyrtim kishte vend për zbatimin e vendimit unifikues edhe për periudhën 01.05.2009-01.07.2009, si dhe përse ligji i identifikuar si i zbatueshëm për këtë periudhë vijon të përmbajë kufizim të masës së pensionit të parakohshëm (jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi), në një kohë kur ky kufizim është shfuqizuar. Në këtë drejtim, nuk duket se Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje shkaqeve të paraqitura në rekurs lidhur me zbatueshmërinë e kriterëve ligjore të parashikuara nga ligji nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, për periudhën 01.05.2009-01.07.2009, si pasojë e shfuqizimit me ligjin nr. 9210/2004 të masës së tavanit të pensionit të parakohshëm apo se ajo

(Gjykata e Lartë) ka dhënë mjaftueshëm argumente për identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe për mënyrën e interpretimit të tij nga gjykata e apelit.

44. Nisur nga sa më lart, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, duhet t'u kthente përgjigje pretendimeve të kërkuarit për ligjin e zbatueshëm dhe kriteret e përcaktimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Pra, ajo gjykatë nuk mund të mjaftohej me një arsyetim të kufizuar, por duhet të mbante qëndrim dhe të arsyetonte qoftë për sa i përket ligjit të zbatueshëm, ashtu edhe në veçanti nëse kufizimi “jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi” përfshinte edhe periudhën kohore 01.05.2009-01.07.2009. Prandaj vendimi i saj nuk plotëson kërkesat për një gjykim të drejtë në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, duke i cenuar kërkuarit edhe parimin e sigurisë juridike në drejtim të së drejtës për pension të parakohshëm të fituar prej tij nga ligji, të paktën për periudhën kohore 01.05.2009-01.07.2009. Në këto kushte, Gjykata, nisur edhe nga roli subsidiar i saj në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, vlerëson se i përket Gjykatës së Lartë të kontrollojë ligjshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të faktit për interpretimin e ligjit material prej tyre, prandaj duhet të shfuqizohet vetëm vendimi i saj.

45. Po kështu, Gjykata vëren se kërkuari ka ngritur pretendime edhe për periudhën pas datës 01.07.2009, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10142/2009, deri në datën 04.03.2013 (*datë kur ka hyrë në fuqi vendimi nr. 2/2013 i Gjykatës*). Lidhur me këto pretendime të kërkuarit, Gjykata, sikurse është shprehur edhe më parë (*shih vendimin nr. 59, datë 16.10.2025 të Gjykatës Kushtetuese*), vëren se interpretimi i nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009, për periudhën pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, pra pas datës 01.07.2009, nga gjykata e apelit dhe pranimi i tij nga Gjykata e Lartë nuk duket i paarsyeshëm dhe që të bjerë ndesh me jurisprudencën e Gjykatës, pra i tillë që e bën gjykimin të padrejtë. Prandaj, pretendimet e kërkuarit në lidhje me të drejtën e pensionit të parakohshëm për periudhën 01.07.2009 – 04.03.2013 janë të pabazuara.

46. Në përfundim, Gjykata çmon se, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, kërkesa është e bazuar, ndaj ajo pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri.

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-4497, datë 22.10.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 12.12.2025

Shpallur më 12.01.2026